

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	I mori mijëra € qytetarit për legalizim fals, "punonjësja" e Kadastrës kapet në kafe në flagrancë
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/14/i-mori-mijera-e-qytetarit-per-legalizim-fals-punonjesja-e-kadastres-kapet-ne-kafe-ne-flagrance/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 19:55:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 19:54:24 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e93b56da17c2869fdad947a81454b34db118c6d478f155ff78767f0e6d569c00
TEKSTI	93fa1e346cd79bdb68bfe3d567a1d347decc533b3fd9695245a304f417564f68
PAMJA	78d490fe912c30d170b4ba7997eeb61e38a1ec3a58ab2a40a4a55ffd3e053496

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	44b68c6476a49bcf6d47700209af43e478a2f4eb1e5a2579c092f2eaff0fd990
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	49912a82e108233a2f4c1eb29c0feee4310e444550233db1ec41850f1c69f554
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/44b68c6476a49bcf6d47700209af43e478a2f4eb1e5a2579c092f2eaff0fd990>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

I mori mijëra € qytetarit për legalizim fals, “punonjësja” e Kadastrës kapet në kafe në flagrancë

21:54 : 14/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE



Emisioni “Stop” trajtoi këtë të hënë, më 14 shtator, rastin e një denoncuesi nga Tirana, i cili tregon, se ra në kurthin e Zana Dodës, e cila në vitin 2024 i ishte prezantuar si punonjëse e Kadastrës.

Ajo i premtoi se, kundrejt 15 mijë eurove, do t'i siguronte dy vendime legalizimi, një për të dhe një për dhëndrin e tij. Komunikimet mes tyre, përmes SMS-ve dhe audiove, zbulojnë premtimet e vazhdueshme të Dodës.

Përmes kamerës së fshehtë, “Stop” dokumentoi marrjen e shumës prej 15 mijë eurosh, për pajisjen me dokumentet e legalizimit. Madje, për të bërë të besueshëm mashtrimin, Doda i dërgoi denoncuesit në WhatsApp tre foto të një vendimi legalizimi, duke pretenduar, se dokumenti ishte nxjerrë në emër të dhëndrit të tij dhe se vendimi për denoncuesin, do të përfundonte brenda javës.

Por verifikimi i “Stop” pranë Kadastrës tregoi, se vendimi i dërguar, ishte i falsifikuar.

Pas përballjes me faktet, Doda premtoi, se do t'i kthente 15 mijë eurot. Por as këtë premtim nuk e mbajti. Ajo tentoi të bindte denoncuesin, se do t'i siguronte hipotekën dhe do t'i kthente një pjesë të parave, me kusht, që ai të tërhiqej nga “Stop”.

Lexo edhe:

[Pesë shkolla në Astir?! Tre vite nga premtimi i Veliajt, asnjë godinë e përfunduar](#)

[Protesta e 106-të në Tiranë/ Policia vë nën hetim 20 protestues: Prishën qetësinë publike](#)

Në bashkëpunim me autoritetet, gjatë takimit të pasdites Zana Doda u arrestua në flagrancë. Hetimet e para tregojnë, se në bashkëpunim me 27-vjeçaren Sara Ndoj, Doda dyshohet, se ka përfituar mbi 100 mijë euro me anë të mashtrimit.

Episodi 1:

Denoncuesi-Zana, unë të kam thënë, kam prit këtu edhe kaq kohë, është e kotë tani...,me

TË GJITHA



I mori mijëra € qytetarit për legalizim fals, “punonjësja” e Kadastrës kapet në kafe në flagrancë

21:54 : 14/09/2026



“Ministrinë e Energjetikës ma lini mua”/ Përgjimi i Roni Yeffet për gazin në Vlorë: Asnjë letër zyrtare...

21:45 : 14/09/2026



Dalin PAMJET/ Si Edi Rama sulmoi me thonj emigrantin shqiptar në Napoli

21:35 : 14/09/2026



Dhunuan barbarisht indianin, arrestohen dy shqiptarët në Greqi

21:21 : 14/09/2026



Seanca në Gjykatën e Lartë/ Nuk gjykohet kryebashkiaku, por individi Erion Veliaj, i akuzuar për korrupsion

21:12 : 14/09/2026



Aleksandër Vuçiq njofton datën e dorëheqjes

21:06 : 14/09/2026



Përfundojnë fjalimet të Kryeministria, protestuesit vërshojnë në rrugët e Tiranës

20:53 : 14/09/2026

aiskullu, çjare kemi inene e çjare me ke inene.

Zana Doda–Absolutisht është e mbyllur, janë të mbaruara dy vendimet edhe e Isës edhe e jotja. Të mundohemi sot, por edhe nesër të paktën me foto, e po ngaqë janë në tavolinën e drejtorit dhe na duhet kështu me i bo foto.

Episodi 2:

Denoncuesi–Jam mërzit...

Zana Doda–Përse?

Denoncuesi–Ëëë ,Zana tani po dal direkt edhe në temë,u bënë dy vjet, o burrneshë! Ja kam të drejtë unë të mërzitem, apo jo?

Zana Doda-Shiko, ta them unë, absolutisht, që ke të drejtë të mërzitesh, por për një gjë, s'ke të drejtë...

Denoncuesi-Hëëë?

Zana Doda-Të hedhësh hije dyshimi dhe kur unë të them, po të betohem, mos e paca atë djalë..! A e ke idenë, unë e kam më të thjeshtë, të të them, “Shaqo...s’është, se i kam marrë unë ato lekë”, ëëë dhe unë të them “Shaqo hajde merr lekët, se...” ,por unë e di shumë mirë, e kam parë të gjithë procedurën, që ai vendim është bërë, madje më është thënë, “Isa do ta marrë i pari, pastaj Shaqo...” dhe ne po presim..., prandaj më vjen inat dhe mu kjo gënjeshtër pafund, pafund, pafund, por janë blloku dhe po i nxjerrin me pikatore. Po kjo, që ti e ke të mbyllur atë vendim, kjo ka marrë fund Shaqo, e ke të mbyllur. Unë po mundohem, që të paktën Isa, inshalla, deri të premtën, të paktën të Isës, do ta coj në Whats up të Isës, të paktën të Isës, deri të premtën....

Denoncuesi-Po pse, e imja nuk bëhet?

Zana Doda-Sepse bëhen me rradhë, po që është e bërë është...dhe këtë ta garantoj unë me 1 miliardë përqind.

Denoncuesi-Po sa do vejë kjo punë, moj Zana kështu?

Zana Doda-Po ka mbaru, nuk ka për të shkuar shumë.

Episodi 3:

Zana Doda-Fare, fare, fare...

Denoncuesi-Kur është ky afati?

Zana Doda-Unë, Isën të thashë, do e marrësh ndoshta deri nga e premtja, ndoshta Isën, tënden....Isa, po, është ë kryme.

Denoncuesi-Po timen?

Zana Doda-Kam përshtypjen edhe një jave më mbrapa.

Denoncuesi–Po a e di, sa herë më ke thënë kështu, të njëjtat gjëra?

Zana Doda-Isën do e marrësh, kaq!

Episodi 4:

Zana Doda-Po patjetër, po më jep kohë, të të marr në telefon! Jo, nuk është nevoja të bëni asnjë lloj veprimi, se do ta zgjidh vetë! Patjetër, patjetër! Unë i përgjigjem me cdo gjë Shaqos. Patjetër! Absolutisht po! 11!

Zana Doda-Vendimi dhe certifikata dalin në a-albania...

Denoncuesi-Po a është origjinale kjo certifikatë?

Zana Doda-Origjinale, po ky nuk është vendimi, është certifikata origjinale e Isës.

Zana Doda-Jo, jo! Shiko, cfarë ndodh! I ka thënë “Stop”i shko merr letrat dhe na i sjell ne...!

Denoncuesi-Po kjo, a është certifikatë origjinale e pronësisë?

Zana Doda-Po, po!

Denoncuesi-Tani unë do marr këto letrat dhe do shkoj tek "Stop"-i.

Zana Doda-Si do t'ia japësh?

Denoncuesi-A më ke mbaruar punë?!

Zana Doda-Se ti ke shkuar vetë tek "Stop"-i, "Stop"-i nuk të merr me zor ty. Ti do i thuash "Stop"-it, sic kam ardhur, unë do të tërhiqem, se e kam zgjidhur privatisht.

Episodi 5:

Bashkëshorti i Zana Dodës-Ore ti, do kishe bërë mirë, mos i kishe thënë "Stop"-it për takimin...!

Denoncuesi-Po ju po më mashtroni edhe sot, as lekë,t as certifikatë...

Zana Doda-Ai është gazetari i "Stop"-it.

/Emisioni STOP

Etiketa: Kadaster legalizim mashtrim Tirane

Lajme të lidhura



Pesë shkolla në Astir?! Tre vite nga premtimi i Veliajt, asnjë godinë e përfunduar

16:10 : 14/09/2026



Protesta e 106-të në Tiranë/ Policia vë nën hetim 20 protestues: Prishën qetësinë publike

11:42 : 14/09/2026



Nisja e vitit të ri shkollor shkakton kaos në qarkullim, rradhë kilometrike deri në afërsi të Paskuqanit

09:32 : 14/09/2026



"2 muaj pa ujë"/ Punimet në Kombinatin lënë banorët pa furnizim, tubacioni kryesor i dëmtuar

19:41 : 13/09/2026



Aksident në Tiranë, urbane përplasen me një automjet te rruga "Bardhyl"

11:23 : 12/09/2026



Tiranë/ Përshtatën apartamentin për prostitucion, arrestohen tre vajza të huaja dhe një shqiptar

14:31 : 11/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto:

NA NDIQ

f i g y